



Njësia i Prokurimit

Istog: datë, 06.05.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Istogut, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 30.04.2019 të parashtruar nga nga **Grup i Operatorëve Ekonomik N.SH. "AL-ING"; N.N.P. BEK-ING, N/A, -, GODEN**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **MBIKQYRJA E PROJEKTEVE KAPITALE.**, me Nr. të Prok: **633-19-436-2-2-1** nxjerr:

VENDIM

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim nga **Grup i Operatorëve Ekonomik N.SH. "AL-ING"; N.N.P. BEK-ING, N/A, -, GODEN**, të dt. 30.04.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit **MBIKQYRJA E PROJEKTEVE KAPITALE.**, me Nr. **633-19-436-2-2-1** Nr. Brendshëm **633/19/002/221**, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK-së, të datës 23.04.2019 të publikuar në web-faqe të E-prokurimit.
2. *Vërtetohet* vendimi i AK i publikuar me datë: 23.04.2019;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit*;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

i Operatorëve Ekonomik N.SH. " AL-ING "; N.N.P. BEK-ING, N/A, -, GODEN, me datë 30.04.2019, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **MBIKQYRJA E PROJEKTEVE KAPITALE**, me Nr. të Prok: 633-19-436-2-2-1; me Nr. te brendshem te prokurimit: 633/19/002/221. Autoriteti Kontraktues, me datë **06.05.2019**, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Tenderi i juaj është i pa përgjegjshme:

- ❖ **KJO OFERTE TEK kërka pika 2.4 KAPACITETI TEKNIK PROFESIONAL 'STAFI PROFESIONAL MUNGON NOTERIZIMI I DIPLOMAVE SI DHE MUNGON EDHE NOSTIFIKIMI I DIPLOMAVE NGA SHTETET E HUAJA.**
- ❖ **NE MESIN E STAFIT PROFESIONAL -KEMI VERIFIKUAR DOKUMENTET E DOSJES SE TENDERIT TE PARAQITURA NE KET OFERTE PER INXH.NGA ISTOGU zot.M.A(sepse kemi njohuri per te se ky eshte i punsuar ne kompanine SHKEMBI),kemi pranuar konfirmim nga vet M.A.se paraqitja e dokumenteve eshte bere pa pelqimin e tij.konfirmimi dt.16.04.2019.**

Autoriteti Kontraktues qendron prane rekomandimit te bere nga Komisioni vleresues edhe pas kerkeses tuaj per ri-shqyrtim. Eshte ekzaminuar ne hollesi oferta juaj dhe AK qendron prapa Vendimit te AK-se te dates 23.04.2019.

- ❖ Ju si Operatore ekonomike konkurues keni deshtuar te plotesoni kapacitetin teknik dhe profesional Per stafin tuaj keni paraqitur Diplome ne gjuhen kroate, duke deshtuar te permbushni kriterin e gjuhes se perdorur ne procedure te prokurimit - gjuhet zyrtare shqip dhe serbisht. Diploma ne gjuhen kroate duhet te kishe perkthimin e noterizuar bashkelidhur, per ta bere si dokument te vlefshem.
- ❖ Ju si Operator ekonomik konkurues keni paraqitur diplomen e inxhinjerit pa pelqimin e tij - kjo perben shkelje te LPP-se neni 65.

-Gjithashtu gjate ekzaminimit te ofertes tuaj pas kerkeses per ri-shqyrtim eshte vrejt se nuk permbushet as kerketat mbi mundesite teknike dhe /ose profesionale - Kerkesa 2:

Kërkesa 2 Kontrata te Projekteve të ngjajshme të sherbimeve të realizuara në tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te njoftimit per kontrate),e vërtetuar nga OE,ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlere minimumi 67.000 euro.

Dëshmia 2 Nje liste te kontratave dhe referenca procesverbalet e pranimit të sherbimeve te leshuar nga punedhensit e tyre, duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të furnizimeve në lëmin e kërkuar. Referencat apo procesverbalet duhet te korespondojne me lister e kontratave.

Ju keni nje Liste kontratave - projekteve te realizuara, ku jane te paraqitura 8 aktivitete te ndryshme, ku 2 nga to jane te viteve 2014 dhe 2015- te cilat nuk permbushin kerkesen e realizimit gjate 3viteve te fundit , duke filluar nga data e publikimit te njoftimit per kontrate, ndersa nga 6 aktivitetet tjera vetem nje aktivite eshte i sherbimeve te ngjajshme dhe ate ne vlere prej 2.087,53 euro.(vlere e kerkuar eshte min.67.000euro), ndersa te tjerat aktivitete kane te bejne me pune te ndryshme por jo mbiqyrje.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit